



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.50/2018
Prishtinë, më 26.11.2018, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Glauk Konjufca, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan:, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami dhe Veton Berisha, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Lulzim Demolli, Luan Morina – MZHE, Halit Hoxha – MZHE, Ilir Shala, Kadri Kadriu – KOSTT, Arsim Janova – ZRRE, Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli – KDI, Dren Abazi – INDEP, Vatra Qehaja, Arta Dehari – LVV, Dren Ajeti - Klubi i Prodhuesve, si dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20 dhe 22.11.2018;**
3. **Raportim i përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese lidhur me procesin e anëtarësimit të NP KOSTT në ENTSO-E;**
4. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 22.11.2018

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 20 dhe 22.11.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese lidhur me procesin e anëtarësimit të NP KOSTT ne ENTSO-E

Kryetarja potencoi se në këtë mbledhje ju kemi ftuar me qëllim që të informohet Komisioni në lidhje me gjendjen në sektorin energjetik dhe votimi në ENTSO-E në lidhje me KOSTT-in. Çështjet që do të adresohen gjatë kësaj mbledhje janë raportimi nga përfaqësuesit e MZHE, KOSTT-it dhe ZRRE-së mbi marrëveshjen e energjisë, mbi shpenzimet e energjisë për komunat veriore, se a është duke ndarë Qeveria e Kosovës fonde për atë energji të shpenzuar në veri, se a është regjistruar kompania e re sipas marrëveshjes, sa është përmbushur marrëveshja, cilat janë sfidat dhe të arriturat, kur do të jetë votimi për anëtarësim në ENTSO-E, po ashtu MZHE do të raportojë për marrëveshjen e energjisë se sa është përmbushur, sa kemi arritur pavarësim të kufijve energjetik. Njoftoj komisionin se ministri z. Valdrin Lluka, sot është në mbledhjen e përbashkët me Qeverinë e Shqipërisë që ka Qeveria jonë dhe përfaqësuesja e ZKM-së znj. Pranvera Dobruna për shkak të agjendës jashtë shtetit s'ka mundur të marrë pjesë në mbledhje.

Halit Hoxha – MZHE, theksoi se anëtarësimi në ENTSO-E është kryekëput teknik, ENSTO-E përfshin rrjetin e transmissioinit të të gjithë vendeve anëtare te Evropës. Në bazë të marrëveshjes për energji, rrjeti i transmissioinit të Kosovës është paraparë të bëhet anëtar i ENTSO-E, me dy kushte që burojnë nga dialogu i Brukselit, e që është regjistrimi i një furnizuesi në pjesën e veriut ky ka qenë kushti që është paraparë në mënyrë që të hiqet e drejta e vetos nga ana e Serbisë për t'u anëtarësuar në këtë organizatë, procesi ka shkuar në atë mënyrë që ministria ka bërë simulimet që të shoh se KOSTT a është në gjendje të përmbush obligimet si zonë e pavarur rregulluese, ky edhe ka qenë kriter teknik që KOSTT dhe është plotësuar. Me vonë Serbia ka bërë tre aplikime dhe nga të tri këto aplikime ka plotësuar diçka, por ka lenë mangët diçka tjetër, por janë vlerësuar si të veçanta dhe si të tilla nuk kanë qenë të pranueshme, sikur të kombinoheshin këto aplikime ato mund të kategorizoheshin konform marrëveshjes. Serbia haptazi është treguar se nuk ka vullnet ta implemetojnë këtë marrëveshje. Në vitin 2016 është hap një rast në Sekretariatit e energjisë, pikërisht për mos kompensimin që KOSTT-i nuk e merr për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe elementi i dytë ka qenë me insistim të gjermanëve dhe me ndërmjetësim të Sekretariatit, kanë filluar një proces teknik të ndërmjetësimit të marrëveshjes, pra paralel me dialogun. Fatkeqësisht Serbia nuk e ka emëruar përfaqësuesin e vet dhe ka bërë që ky proces të dështojë. ENTSO-E ka kërkuar rrugë alternative në nivelin teknik për anëtarësim të Kosovës në këtë organizatë, duke tentuar që me tri marrëveshje bilaterale që mund të lidhë KOSTT-i me anëtarët e tjerë të kërkohet rrugë tjetër për anëtarësimin e KOSTT-it në ENSTO-E, Serbia ju ka dërguar letër të gjitha vendeve anëtare të ENTSO-E duke kërcënuar se do t'i padisë sepse kjo është kundër marrëveshjes dhe shumica e këtyre vendeve janë tërhequr. Për procesin teknik mund të japë me shumë detaje përfaqësuesi i KOSTT-it.

Ilir Shala – Kryeshef i NP KOSTT-it, tha se marrëveshja politike për energji, përmban edhe pikën kryesore që furnizimi i pjesës veriore duhet të bëhet nga “Elektrosever”, kompani e cila duhet të ishte regjistruar deri më tani sipas kriterëve ligjore të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst në vitin 2015 është nënshkruar marrëveshja për regjistrimin e kësaj kompanie, mirëpo deri me tani nuk është licencuar dhe regjistruar. Dënimet që janë shkaktuar në mënyrë të paqëllimshme janë si rezultat i energjisë në veri të vendit, deri me tash borxhi total që e ka KOSTT-i sillet rreth 224 Gigavat orë ose 11.5 milionë euro. Ne kemi dhënë një propozim për zgjidhje të përkohshme deri me 31 mars me qëllim që të ndalen dënimet, dhe KOSTT-i të jetë *de facto* zonë apo bllok rregullues i vetëm që do të ishte përfitim i madh, mirëpo pala serbe ka bërë propozime të ndryshëm para ENTSO-E dhe ENTSO-E e ka gjetur një propozim të ndërmjetëm që e fut “Ujmanin” në kuadër të Serbisë dhe për neve një propozim i tillë ka qenë i papranueshëm, dhe si i tillë ky votim nuk është përkrahur sepse ka qenë i refuzuar nga të dy palët.

Arsim Janova – ZRRE, theksoj se ZRRE është zotuar që në momentin që kompania serbe aplikon dhe i ka të kompletuara dokumentet në bazë të kriterëve ligjore atëherë në afat prej 7 ditëve do të lëshojmë licencën, pra për shkak të rëndësisë që ka do ta trajtojmë në afate rekorde.

Dardan Sejdiu pyeti se pse jemi nga viti 2013 e tutje duke u marrë ende me këtë temë, a është marrëveshja e viti 2015 bazë për çfarë po bisedohet sot me Serbinë, a ka aplikuar EPS-i në gusht të vitit 2015 sipas marrëveshjes për regjistrim të “Elektroseverit” në Kosovë, nëse ka aplikuar pse nuk është bërë regjistrimi në atë kohë, a është EPS pronar 100% i “Elektroseverit”, pra, a është një ndërmarrje shtetërore serbe pronare në një ndërmarrje në Republikën e Kosovës, nëse po a e ka dikush strukturën aksionare të “Elektroseverit” parasysh dhe financimin e kësaj kush e bën, a merr të hyra nga shteti i Serbisë, a paguhet rryma në veri të Kosovës dhe kush i inkason ato mjete, pas aplikimit në çfarë afati kohore merret një licence nga ZRRE?

Lutfi Zharku tha sipas Kushtetutës dhe ligjeve pjesa e veriut është pjesë e jona, pse ne nuk jemi të lidhur ku është problemi?

Glauk Konjufca tha se ne kemi pasur vërejtjet tona qysh në vitin 2013 kur është diskutuar dhe pastaj në vitin 2015 kur është nënshkruar kjo marrëveshje dhe në çdo marrëveshje që arrihet është një element që nëse ke arritur t’i mbrosh interesat shtetërore dhe ajo marrëveshje shkelet, atëherë a kemi të drejtë të dalim nga ajo marrëveshje, nëse kemi të drejtë të dalim cilat janë perspektivat e daljes. Si e mendoni çështjen e zgjidhjes se pavarësisë së KOSTT-it si zonë e rregulluese e pavarur operative?

Ilir Shala – NP KOSST, në lidhje me regjistrimin e “Elektroseverit” ne, si institucion, nuk jemi thirrur zyrtarisht, në vitin 2015 në bazë të informatave që kemi aplikimet kanë qenë jo konform kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, sa i përket pagesës së rrymës në veri të vendit, në takimin e fundit që kemi pasur në Bruksel me vete faktin se pjesëmarrës ka qenë edhe drejtori i “KOSMET-it”, siç e quajnë ata, që pritet të shndërrohet në “Elektrosever”, siç është paraparë me ligjet e Kosovës. Rryma në veri paguhet, por se ku dhe kush i merr ato mjete nuk kemi informacione dhe kjo është shqetësuese edhe për mua. Sa i përket pyetjes se si është i lidhur sistemi transmetues me pjesën veriore, është i lidhur me linjat ndërlidhëse përmes një aseti që

kemi atje përmes tri linjave që shkojnë prej “Kosovës A” apo nënstationit të Vushtrrisë dhe Skenderajt, ky trafostacion është i lidhur me Novi Pazarin, pjesën e Serbisë përmes linjës 110 kilovolt. sa i përket asaj se a po negociohet konform marrëveshjes se arritur ne vitin 2013, është fakt nga ajo marrëveshje kanë dalë edhe kornizat tona me të cilat negociojmë.

Arsim Janova – ZRRE, sa i përket kompanisë se “Elektrosever” ende nuk ka aplikuar për licence, jemi në pritje, sa i përket afateve ne zakonisht kemi afate deri në 90 ditë, por ne do ta trajtojmë në afate rekorde dhe në kohën sa më të shpejtë do ta licencojmë, por pa shkelur asnjë kriter gjatë licencimit, por për shkak të rëndësisë së procesit do të jemi efektiv në kohë.

Dardan Sejdiu: Në bazë të raportit të KDI, paraqiten elemente që duhen korrigjuar në aplikim për regjistrim të biznesit në Kosovë, a mund të më tregoj dikush se a janë bërë këto korrigjime ne aplikimin e fundit apo jemi tërhequr nga kriteret që kemi kërkuar, a ia ka vlejtur kjo orvatjes e higjienës në dokumentacion. Këto tre aplikacione që po i referoheni, a mund të më thoni kur ka qenë aplikacioni i fundit?

Halit Hoxhaj – MZHE, sa i përket aplikimit të “Elektrosever-it” ata kanë aplikuar tre here dhe në çdo aplikim kanë përmirësuar diçka, por kanë bërë lëshime në disa kriteret të tjera, kjo i bie se ata nuk kanë inventivë ta ecin marrëveshjen përpara, komentet tuaja janë të referuara në aplikimin e parë të “Elektroseverit” dhe shoh se ne këtë drejtim raporti i KDI-së është i vonuar. Presioni tani është i vendosur në palën tjetër dhe kjo nuk varet nga ne. Sa i përket asaj se kur ka qenë aplikacioni i fundit mund të këtë qenë në prill të 2016-ës.

Kryetarja theksoj se ne duhet të jemi të vëmendshëm edhe në detale sepse janë marrëveshje të rëndësishme dhe duhet të kemi shumë kujdes, mirëpo pyetjet e deputeteve janë krejt normale sepse në një nga takimet në Bruksel është thënë nga një zyrtar i lartë i Parlamentit Evropian se për shkak të neglizhencës së zyrtareve që regjistrojnë aplikacione jeni vonuar. Ne e dimë që Serbia nuk lë metodë pa e provuar për të na dëmtuar dhe duhet të jemi të vëmendshëm.

Halit Hoxhaj – MZHE, tha se sa i përket asaj që qe potencuar për neglizhencë nga ana e zyrtarëve në lidhje me regjistrimin e aplikacioneve, neve nga disa zyrtar të Komisionit Evropian në atë kohë na kanë thënë se statuti është dokument i brendshëm i kompanisë dhe nuk ka pse ju shqetëson se a shkruan “Kosovo Metohi” apo jo, kjo nuk ka qenë e pranueshme për ne dhe është refuzuar, pra nuk ka të bëjë me neglizhencë.

Muharrem Nitaj tha se me sa po shoh operatori serb për energji paska marrë lejen për biznes, ndërsa, certifikimin pritet ta bëjë në ditët në vijim, dhe ju po premtoni se këtë mund ta bëni në afat prej 7 ditëve duke shkelur edhe afatet për interes të çështjes, a mund të jetë e kushtëzuar kërkesa për licencë mbas masës prej 100% për produktet serbe? Çka nëse dështon prapë futja në zbatim të kësaj marrëveshje? Dhe me intereson ta dijë se pse kanë ndodhur reduktimet e ashpra të energjisë eklektike në vend, a e keni analizuar se pse ka ndodhur dhe cilat kanë qenë arsyet?

Duda Balje tha se jam gati 100% e sigurt se Serbia do ta bojkotojë këtë marrëveshje sikurse marrëveshjet e tjera, çka do të veprojmë tutje? Ministri ka thënë se kemi edhe një mundësi në asamblenë e ENTSO-E, a keni aplikuar për anëtarësim që t'i definojmë kufijtë energjetik ne Kosovë?

Memli Krasniqi tha se jemi të befashuar nga vota kundër në ENTSO-E e dy shteteve mike siç është Hungaria dhe Bullgaria, por edhe abstenimi i dy shteteve të tjera fqinje, siç janë Maqedonia dhe Mali i Zi. Pavarësisht se kur dhe si vendoset për votim, a është dikush nga ju duke u marrë me këtë punë apo jeni dakorduar me Ministrinë e Punëve të Jashtme në lidhje me lobimin të këto shtete.

Illir Shala – NP KOSST, tha se në pyetjen e z. Krasniqi këtë përgjigje veç e kemi dhënë dhe jemi sqaruar. Në lidhje me atë se a po paguan ndokush për konsumin e energjisë në veri, përgjigja është jo, këtë energji ne po e marrim nga rrjeti evropian. Sa i përket reduktimeve të energjisë elektrike pas vendosjes së taksës 100% për produktet e Serbisë, nuk është në kompetencën e KOSTT-it, me mirë mund të përgjigjet përfaqësuesi i ZRRE-së. Sa i përket pyetjes se a kemi edhe një shans në asamble, përgjigja që ka dhënë ministri ka të bëjë me zgjidhjen e përkohshme që ka propozuar ENTSO-E, mirëpo me vetë faktin që bërë lëshimi i certifikatës së biznesit më nuk ka opsion për zgjidhje të përkohshme.

Arsim Janova – ZRRE, sa i përket asaj që tha z. Nitaj në lidhje me shkeljen e afatit për licencim, dua të potencoj se nuk është shkelje e afatit, por është procedurë e cila përshpejtohet dhe kryhet brenda afatit ligjor. Sa i përket reduktimeve të energjisë ne jemi në proces të monitorimit, këto reduktime kanë ardhur në emër të prishjeve dhe mirëmbajtjeve, dhe tani ne kemi lejuar mjete pavarësisht çmimit që të realizohen blerje dhe të mos ketë reduktime.

Luan Morina - MZHE, sa i përket trajtimit të licencës dhe nevojës për licenca, nëse ndodh amendamenti i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ne më nuk kemi mundësi të kërkojmë licence të një operatori i cili dëshiron me vepruar në Kosovë, në një të ardhme të afërt mund të mos kemi nevojë për licenca fare. Sa i përket njohjes së licencave do të shkojmë shtet me shtet dhe jo rregullator me rregullator, pra do të jemi reciprok në mënyre bilaterale.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të monitorojë rreptë procesin e anëtarësimit të NP KOSTT në ENTSO-E, dhe do të kërkojë raport nga MTI lidhur me regjistrimin kompanisë përkatëse për furnizim me energji në veri të vendit.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese

**Mbledhja përfundoi në orën 13:15.
E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA